



AKT THEMELIMI
I SHOQERISE "TETE ALBANIA TUNNEL & MINING" SH.P.K

Sot me date 30 03.2007, Shoqeria turke "TETE MADENCILIK VE MUHENDISLIK SANAYI VE TICARET A.S." perfaqesuar me autorizimin nr.05 dt 19.03.2007 nga z.Hasan USTUNDAG, shtetas turk, i biri i Aliut, i datelindjes 01.01.1973, lindur ne Elbistan Turqi, ne cilesine e perfaqesuesit te themeluesit te kesaj Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar, ne te cilen ajo do te jete ortak e vetme, vendosi te hartoje kete Akt-Themelimi, mbeshtetur ne parimet e meposhtme:

NENI 1.

Shoqeria Tregtare "TETE ALBANIA TUNNEL & MINING" SH.P.K themelohet si Shoqeri Tregtare, bazuar ne ligjin Nr.7638 date 9.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare".

Shoqeria, ne marrdheniet me te tretet, mund te emertohet shkurtimisht "TETE ALBANIA" SH.P.K. Ky emertim, ne cdo rast, ka te njejten vlere ligjore si edhe emertimi i plote i shoqerise.

Ajo eshte Person Juridik Privat Shqiptar.

Selia e saj ndodhet ne Qytetin e Tiranës me adrese Blv. "Deshmoret e Kombit" Twin Towers, Kulla 1, Kati 5.

Ne varesi te aktivitetit tregetar shoqeria mund te hape dege apo filiale te saj ne qytete te ndryshme te Shqiperise ose jashte vendit, sipas legjislacionit te vendit perkates

Ndryshimi i selise se shoqerise do te behet ne formen e kerkuar nga ligji.

NENI 2.

Veprimtaria e Shoqerise bazohet ne normat e ketij Akti Themelimi, Statutit te Shoqerise, si dhe Legjislacionit Shqiptar ne fuqi.

Themeluesi i saj mban pergjegjesi vetem per detyrimet qe krijon Shoqeria dhe brenda vleres se kapitalit themeltar.

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet qe mund te kete ortakut themelues para krijimit te saj, si dhe per detyrimet e ortakëve te tjere (ne rast se ka) para futjes ne shoqeri apo per shkak te veprimtarive te tjera.

NENI 3.

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte i perbere nga kontributi i Ortakut themelues ne vleren 100 000 (njqind mije) leke.

Kapitali themeltar eshte investuar nga Ortaku i Vetem dhe themelues **Shoqeria "TETE MADENCILIK VE MUHENDISLIK SANAYI VE TICARET A.S."** ne gjithe madhesine e tij dhe ne masen 100 % te vleres se kapitalit themeltar.

Vleresimi i kapitalit themeltar eshte bere nga Ortaku themelues me rastin e miratimit te ketij Akti Themelimi dhe eshte nenshkruar prej tij.

Zmadhimi i kapitalit te shoqerise do te behet ne formen e parashikuar nga ligji.

Shoqeria ka te drejte te transferoje kapitalin e saj.

NENI 4.

Shoqeria, nepermjet perfaqesuesit te saj ne Shqiperi, ka depozituar prane noteres, kapitalin ne te holla, ne daten e nenshkrimit te ketij Akti Themelimi.

Mbas regjistrimit te Shoqerise, kjo shume do te kaloje ne llogarine e kesaj Shoqerie qe do te celet prane njeres prej Bankave operuese ne shtetin Shqiptar.

Shoqeria rezervon te drejten e terheqjes se kredive prej bankave qe zhvillojne aktivitetin tregtar ne Shqiperi, sipas kritereve te percaktuara prej tyre.

NENI 5.

Objekti i Veprimtarise te shoqerise.

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj :

- Nxjerrje, perpunim, pasurim, tregetim me shumice dhe pakice, import-eksport, i te gjithe llojeve te mineraleve (si baker, krom, hekur, nikel, zink, qymyrguri... etj), xeherore dhe jo xeherore, dhe te nenprodukteve te tyre.
- Nxjerrje, perpunim, prerje , tregetim me shumice e pakice, import-export, e te gjithe llojeve te gureve (si gur, mermmer, granit... etj) , deri ne pergatitjen dhe ofrimin e produktit te gatshem.
- Ndertim rruges dhe konstruksion e hapje tunclesh, nen dhe mbi toke.
- Financim, pergatitje, zbatim dhe konsulence ne fushen inxhinierike, minerare dhe te ndertimit.
- Tregetim me shumice dhe pakice, per import dhe eksport, i mallrave te ndryshem tekstile dhe industriale.
- Financime ne fusha te ndryshme.

Shoqeria brenda hapesirave te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi,do te kryeje cdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet drejtperdrejt ose terthorazi me objektin e veperimtarise se saj.

Kjo perfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive te reja, krijimin e siper marrjeve te reja dhe pjesemarrjen ne siper marrje te tjera, si brenda dhe jashte vendit, pa cenuar objektin e shoqerise.



Cdo shtim ose pakesim i objektit te veprimtarise do te behet sipas parashikimeve ne statut dhe ne legjislacionin ne fuqi.

NENI 6.

Shoqeria do te funksionojë me nje afat kohor te pakufizuar.

Afati i fillimit te veprimtarise fillon mbas regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar.

Ajo mund te pushoje aktivitetin e saj ne cdo kohe kur jane rastet e parashikuara ne ligj ose me vendim te ortakut themelues (asamblese se ortakeve), duke u zbatuar procedurat e caktuara me ligj.

NENI 7.

Ortaku i vetem dhe themelues mund te vendose lirisht per pranimin ne shoqeri te personave te tjere me cilesine e Ortakeve, pasi te jene kryer procedurat e nevojshme te parashikuara nga ligji.

NENI 8.

Ortaku i vetem dhe themelues si dhe ortakët e tjere ne te ardhmen mund te heqin dore nga Shoqeria, por gjithnje per shkaqe te perligjura.

Heqja dore, nuk e shkarkon ortakun nga detyrimet e Shoqerise deri ne momentin e heqies dore. Ne rast vdekje te njerit prej ortakeve detyrimet u kalojne trashegimtareve ligjore sipas aktit te trashegimnise se leshuar nga organi kompetent.

NENI 9.

Investimet dhe veprimtaria e Shoqerise gezojne mbrojtjen e shtetit Shqiptar, i cili krijon te njejtat kushte si per subjektet shqiptare ashtu edhe ato te huaja.

NENI 10.

Fitimi i realizuar kalon ne pronesi te Ortakut te vetem dhe themelues ose te ortakeve te tjere (nese ka), ne perputhje me pjesemarrjen e ortakeve ne kapitalin themeltar.

Fitimi eshte lirisht i transferueshem brenda edhe jashte shtetit shqiptar.

NENI 11.

Ortaku i vetem ka sidomos keto detyrime:

-Te regjistroje Shoqerine ne Regjistrin Tregtar dhe te marri lejen e ushtrimit te aktivitetit te veprimtarise se tyre.

-Te derdhe kapitalin e nevojshem per fillimin e aktivitetit te Shoqerise.

-Te siguroje mjediset e nevojshme per fillimin e aktivitetit, makinerite, lendet e para e ndihmese.

-Te siguroje mundesite e specializimit te fuqise punetore dhe specialisteve per zhvillimin e aktivitetit te Shoqerise.

-Te siguroje objektet dhe makinerite e Shoqerise nga cdo lloj demtimi.

-Te menaxhoje prodhimin e ta reklamojne ate nepermjet mjeteve te ndryshme te informacionit.



NENI 12.

Organet drejtuese te Shoqerise jane :

- Asambleja e Ortakeve.
- Administratori.
- Ekspertet Kontabel.

Administratori i shoqerise eshte caktuar z. **ŞAHİN ÇELİK**, shtetas turk, i dtl. 26.09.1958.

Kompetencat e administratorit te shoqerise percaktohen ne Statutin e shoqerise.

Menyra e veprimtarise se tyre eshte percaktuar ne Statutin e Shoqerise.

NENI 13.

Per kryerjen e aktivitetit te saj tregtar shoqeria mund te punesoje specialiste apo punctore vendas apo te huaj sipas rregullave perkatese. Marredheniet e punesimit do te rregullohen me anen e kontrates dhe brenda legjislacionit shqiptar.

Shoqeria mund te hyje ne marredhenie kontraktuale me subjekte te tjera brenda apo jashte vendit, duke u rregulluar keto marredhenie ne bazen e kontrates.

NENI 14.

Ortaket detyrohen te ruajne sekretin e themelimit dhe te veprimtarise se Shoqerise.

Te punesuarit dhe te ngarkuarit me drejtimin e Shoqerise mbajne pergjegjesi dhe detyrohen te zhdemtojne Shoqerine per demet qe i jane shkaktuar per faj te tyre gjate ushtrimit te veprimtarise se tyre.

NENI 15.

Ortaket mund te vendosin me vullnetin e tyre, per pjesmarrjen ne Shoqeri te tjera dhe te krijojne cdo lloj aktiviteti tjetër privat.

NENI 16.

Mosmarrveshjet lidhur me themelimin dhe zhvillimin e veprimtarise se Shoqerise zgjidhen nga vete Ortaket e Shoqerise me ane te mirkuptimit dhe kompromisit dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga gjykata kompetente.

Po keshtu mosmarreveshjet midis te treteve dhe shoqerise si dhe midis shoqerise dhe personave te punesuar ne te, ne rast se nuk zgjidhen ne rrugen e mirekuptimit do te zgjidhen nga gjykata kompetente.

Gjykata kompetente per zgjidhjen e mosmarrveshjeve eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.


NENI 17.

Problemet e pa trajtuara ne Aktin e Themelimit apo te trajtuara shkurt do te zgjidhen gjithmone sipas kerkesave te ligjit baze "Per shoqerite tregtare".

NENI 18.

Akti i Themelimit, pasi u hartua ne prezencen e perkthyeses Teuta Ustundag, u lexua nga perfaqesuesi i Ortakut Themelues dhe u nenshkrua prej tyre pa verejtje para Noteres te vendit te themelimit te Shoqerise.

**Perfaqesuesi i ORTAKUT THEMELUES
Hasan USTUNDAG**

Hasan USTUNDAG


**Perkthyesja
Teuta Ustundag**

Teuta Ustundag
2007
